



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:244839

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05483149

P.nr.831/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Shqipe Kastrati, në çështjen penale kundër të pandehurit K.M nga fshati .....Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 323 paragrafi 1 i KPRK-ës, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokati Abdylaziz Sadiku nga Gjilani, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, me numër PP.II.nr.1754/2023, të datës 14.11.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik në të cilin kanë prezantuar prokurorja e shtetit Rozelida Manastiri dhe i pandehuri K.M, me mbrojtësin e tij avokatin Abdylaziz Sadiku, me datë 19.03.2024, mori dhe shpalli, ndërsa me datë 21.03.2024 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri K.M nga babai R dhe nëna M, e lindur A, i lindur me datë .....në Gjilan ndërsa me vendbanim ne fshatin ....., Komuna e Gjilanit, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me numër personal .....

ËSHTË FAJTOR

Sepse në muajin Korrik, të vitit 2022, në kohë të papërcaktuar, në fshatin....., Komuna Gjilan, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete, e ka mashtruar të dëmtuarin Z.B, në atë mënyrë që nga i dëmtuari ka marrë 400 € (katërqind euro) dhe për këto para, i ka premtuar se do t'ia dërgoj-shes një sasi të druve, rreth 12 metra, ku një pjesë të druve prej 6 (gjashtë) metra ia kishte dërguar, ndërsa 6 (gjashtë) metra dru deri më sot, i pandehuri, nuk ia ka dërguar

e as nuk ia ka kthyer paratë, me çka i pandehuri me anë me anë të paraqitjes së fakteve të rreme dhe mashtruese, e ka mashtruar të dëmtuarin, duke i shkaktuar dëm material në vlerë të papërcaktuar ;

- Me çka ka kryer veprën penale mashtrimi nga neni 323 paragrafi 1 i KPRK-ës.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-ës dhe nenit 242 të KPP-ës, të pandehurin e lartcekur:

### E GJYKON

Me dënim me gjobë në shumë prej 400 € (katërqind euro), të cilën obligohet ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 140 (njëqindedyzet) ditësh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë të dëmtuarit Z.B ia kompenson dëmin e shkaktuar me vepër penale përkatësisht të njëjtit ia kompenson apo dërgon pjesën tjetër të drunjtëve dhe atë në 5.5 m3.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguajë dënimin me gjobë atëherë dënimet me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do të caktohet një ditë burgim.

Njoftohet i pandehuri i lartcekur se nëse brenda periudhës së caktuar kohore si më lart nuk e kompenson dëmin e shkaktuar me vepër penale atëherë do të ekzekutohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 140 (njëqindedyzet) ditëve.

URDHËROHET Shërbimi Sprovues i Kosovës – Zyra Rajonale në Gjilan që të mbikëqyr dhe të ekzekutoj dënimin me kusht.

Gjykata duke pasur parasysh se të pandehurin e lartcekur e ka obliguar që të dëmtuarit t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar me vepër penale brenda afatit të caktuar kohor, sa i përket kërkesës pasurore juridike dhe në rast të mos përmbushjes së detyrimit të lartcekur nga i pandehuri atëherë i dëmtuari një kërkesë të tillë mund ta realizoj në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohet i pandehuri i lartcekur që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 50 € (pesëdhjetë euro) si dhe shumë prej 20 € (njëzet euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

## ARSYETIM

### 1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 14.11.2023, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.1754/2023, kundër të pandehurit K.M nga fshati Zhegër, Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 323 paragrafi 1 i KPRK-ës.

Më datë 19.03.2024 në këtë gjykatë është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën kanë prezantuar prokurorja e shtetit Rozelida Manastiri dhe i pandehuri K.M, me mbrojtësin e tij avokatin Abdylaziz Sadiku, në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar plotësisht aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e saj, me ç' rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 242 të KPP-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit.

### 2.Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata në seancën e shqyrtimit fillestar në të cilin kanë prezantuar palët e lartcekura pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 242 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezentë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza lëndore siç janë: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2022-CA-1432, i datës 03.10.2022, deklaratat e të dëmtuarit Z.B, deklaratat e të pandehurit K.M, foto

dokumentacioni, raporti i zyrtarit policor E H si dhe shkresat tjera që ndodhën në dosjen e lëndës, po ashtu me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

### 3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartë cekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri i K M nga fshati ....., Komuna e Gjilanit ka kryer veprën penale mashtrimi nga neni 323 paragrafi 1 i KPRK-ës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### 4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij ashtu që me rastin e matjes së dënimit gjykata mori parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës siç janë shkalla e përgjegjësisë penale në të cilën përfshihet fakti se i njëjti ka qenë plotësisht i përgjegjshëm për veprimet e veta, po ashtu me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh edhe pranimin e fajit nga ana e të pandehurit si dhe rrethanat personale të tij.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata është bazuar edhe në rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 70 të KPRK-ës me ç'rast si rrethana lehtësuese për të pandehurin mori pranimin e fajësisë nga ana e tij për kryerjen e veprës penale, pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, keqardhjen e shfaqur nga ana e të pandehurit për veprimet e ndërmarra, kërkim faljen e tij, premtimin e tij që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera si dhe gatishmërinë e të njëjtit që të dëmtuarit t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar me vepër penale, ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurin gjykata këmbëngulësinë e shfaqur nga i pandehuri me rastin e kryerjes së veprës penale ngase i njëjti duke i premtuar të dëmtuarit se do t'ia dërgonte 12 metra drunjë, fillimisht ia merr shumën prej 400 € (katërqind euro), ia dërgon 6 metra drunjë pro pjesën tjetër nuk ia dërgon dhe nuk i përgjigjet për dëmin e shkaktuar, andaj duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-ës, gjykata të pandehurit i shqiptoj dënimin

si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjithnjë duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës, të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprës penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Me rastin e kushtëzimit të dënimit me burgim, gjykata bazuar në nenin 48 paragrafi 3 të KPRK-ës, të pandehurit të lartcekur ekzekutimin e dënimit me burgim ia kushtëzoi me kompensimin e dëmit të shkaktuar me vepër penale dhe atë në afat prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë duke e paralajmëruar të njëjtin se nëse nuk e kompenson dëmin ashtu siç është përcaktuar nga gjykata atëherë do të ekzekutohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 140 (njëqindëdyzet) ditëve.

#### 5. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike

Sa i përket kërkesës pasurore juridike dhe duke pasur parasysh se gjykata ekzekutimin e dënimit me burgim të pandehurit të lartcekur ia kushtëzoi me kompensimin e dëmit të shkaktuar me vepër penale atëherë nëse i pandehuri nuk e përmbush obligimin e caktuar nga gjykata dënimi me burgim do të ekzekutohet ndërsa i dëmtuari kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest të rregullt juridiko civil.

#### 6. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë ta paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 50 € (pesëdhjetë euro) si dhe shumën prej 20 € (njëzetë euro), për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.831/2023, me datë 21.03.2024

Zyrtarja Ligjore,  
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Rilind Sermahaj

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjilan.